



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

V E N D I M

Nr. 134, Datë 02/10/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 116, datë 20.09.2019, e Znj. B.S., ku pretendohet për diskriminim, për shkak të “gjendjes shëndetësore”, nga ana e mjekes kardiologe I.L., anëtare e KMCAP Korçë.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se ankuesja B.S. është përfituese e kemp-it me vendime të KMCAP Korçë, për periudhën kohore 2012 -2016, pasi ajo vuan nga sëmundje kardiake. Ankuesja pretendon se në muajin mars 2017 i është ndërprerë kemp-i, pasi mjekja kardiologe I.L., anëtare e KMCAP-së Korçë ka kërkuar nga ankuesja, që kjo e fundit të kryejë analizën e koronarografisë dhe dokumentacionin përkatës ta depozitojë pranë KMCAP-së. Znj. B.S. shprehet se e ka të pamundur ta kryejë koronarografinë, pasi kjo ndikon negativisht në psikologjinë e saj. Moskryerja e një analize të tillë, e si pasojë mosplotësimi i dokumentacionit të duhur pranë KMCAP Korçë e ka penalizuar ankuesen, për të përfituar kemp nga muaji mars 2017 e në vijim. Për këtë arsye, ankuesja B.S. pretendon se diskriminohet nga mjekja kardiologe I.L., për shkak të gjendjes shëndetësore.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 116, datë 20.09.2019, e Znj. B.S., Komisioneri vlerëson se:

Në pikën I/1, të Vendimit nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, (i ndryshuar) përcaktohet se personat, të cilëve u është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, të intelektit, psikiko/mendore, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje, të përkohshme apo të përhershme, që nuk vijnë nga shkaqe, që lidhen me punësimin, e vërtetuar kjo nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në pikën III/19, të Vendimit nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, (i ndryshuar) përcaktohen shprehimisht procedurat dhe dokumentacioni për përfitimin e pagesës për aftësi të kufizuar, si vijon:

“Personat, që kërkojnë të komisionohen për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, duhet të paraqesin në seksionet e ndihmës dhe të përkujdesjes shoqërore të bashkisë/komunës, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Çertifikatën e gjendjes familjare;
- b) Çertifikatën personale me fotografi;
- c) Vendimin e mëparshëm të KMCAP-it, i cili vërteton shkallën e aftësisë së kufizuar të personit;
- ç) Fletëdrejtimin për në KMCAP, kur personi komisionohet për herë të parë;
- d) Epikrizën përcjellëse, sa herë rikomisionohet.”

Në Rregulloren e datës 30.05.2005, së ISSH-së dhe MSH-së “Për Organizimin, të Drejtat, Detyrat dhe Funkcionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të Invalidëve” citohet: “Nga specialistët, konsultat ose spitali, kur invalidi paraqitet për rikontrollin e rradhës, duke e pajisur me “Epikrizë përcjellëse”, që plotësohet saktë, qartë dhe me përgjegjësi, duke evidentuar gjendjen shëndetësore të invalidit nga kontrolli i fundit, deri në rikontrollin e radhës. Në rikontroll, krahas epikrizës përcjellëse, invalidët pajisen edhe me analiza dhe ekzaminime që janë të domosdoshme, për evidentimin e plotë të gjendjes shëndetësore të tij”.

Sikurse është cituar më sipër, në rikontrollin e rradhës, individët me aftësi të kufizuar mund të kryejnë edhe analiza dhe ekzaminime, që janë të domosdoshme, për evidentimin e plotë të gjendjes shëndetësore të tij, të cilat rekomandohen nga mjekët specialistë.

Mbështetur në dokumentin “Fletëdalje”, të lëshuar në datën 13.11.2017, nga Pavioni i Kardiologjisë, i Spitalit Rajonal Korçë rezulton se për ankuesen është rekomanduar kryerja e analizës së Koronarografisë. I njëjti fakt rezulton edhe në Rubrikën “Plani i ndjekjes” të dokumentit “Përgjigje-Rekomandim”, ku citohet: “Komisioni i KEMP-it kërkon Coronarografi QSUT për trajtim aftësie në punë”.

Për sa më sipër, në referencë të simptomave të shfaqura dhe të konstatuara tek ankuesja, nga mjekët kardiologë të institucioneve përgjegjëse mjekësore, rezulton se Znj. B.S. shfaq disa prej atyre të përmendura më sipër. Komisioneri gjykon se mjekët specialistë të KMCAP, janë ata që gjykojnë mbi llojin e ekzaminimeve dhe analizave, që duhet të kryejnë pacientët, që duan të përfitojnë Kemp. Në këtë kontekst, pavarësisht gjendjes psikologjike, që mund të krijojë tek ankuesja, një ekzaminim i tillë duhet kryer, në kushtet kur është vlerësuar dhe rekomanduar si i nevojshëm nga mjeku kardiolog.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se KMCAP Korçë dhe mjekja kardiologe kanë vepruar konform parashikimeve të akteve nënligjore të sipërcituara.

Neni 33, pika 4, gërma ç), i Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikon mospranimin e ankesës, kur kjo e fundit është haptazi e pabazuar.

Në rastin konkret, Komisioneri gjykon se ankesa nr. 116, datë 20.09.2019, e Znj. B.S., është e papranueshme, pasi është haptazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 4, nenin 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç), të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

- 1.** Mospranimin e ankesës nr. 116, datë 20.09.2019, e Znj. B.S., ku pretendohet diskriminim, për shkak të “gjendjes shëndetësore”, nga ana e mjekes kardiologe I.L., anëtare e KMCAK Korçë, pasi kjo ankesë është haptazi e pabazuar.
- 2.** Kundër këtij vendimi lejohet ankim, brenda afatit ligjor, pranë gjykatës kompetente.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONER

**Në mungesë dhe me porosi,
DREJTORE JURIDIKE**

Ardiana HALA

Fusha – te mira dhe sherbime
Shkak – aftesi e kufizuar

